

# AKT THEMELIMI

## I SHOQËRISË "DANIELI MILLENNIUM" SHPK

Sot, në Tiranë, më 05/09/2018, unë Daniel Fusha , hartoj Aktin e Themelimit me një themelues të vetëm të shoqërisë "DANIELI MILLENNIUM" shpk, sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar në fuqi, me dispozitat që vijnë:

### Neni 1

#### Themelimi

Shoqëria krijohet dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe sidomos Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", aktet e tjera ligjore që do të jenë në fuqi gjatë veprimtarisë së Shoqërisë, si dhe me dispozitat e Statutit të Shoqërisë që i bashkangjitet këtij Akti Themelues.

- 1) Emri i shoqërisë është "DANIELI MILLENNIUM" Shpk (këtu më poshtë e quajtur "Shoqëria"). Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 2) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 3) Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin e saj.

### Neni 2

#### Selia

- 1) Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Tiranë, Njësia Bashkiake nr.5, Rruga "Shkëlqim Fusha" Zona Kadastrale nr.5/3, Nr.Pasurisë 2/874, Kati 4.
- 2) Shoqëria mund të themeloje degë në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin.

### Neni 3

#### Objekti

Objekti i Shoqërisë është si më poshtë vijon:

- 1) Tregëtim me shumicë dhe pakicë i materialeve të ndryshme të ndërtimit si dhe mallrave industriale të të gjitha llojeve .
- 2) Punime dhe shërbime në ndërtim ( Muraturë, termoizolim fasade,shtrim pllakash,suvatime te brendshme e te jashtme, lyerje me boje, instalime elektrike dhe hidraulike ), etj .
- 3) Shërbime pastrimi të të gjitha llojeve.
- 4) Administrim pallatesh.

**Shoqëria mund të zhvillojë çfarëdo lloj aktiviteti tjetër të afërt ose që lidhet me objektin e saj, e vetme ose me pjesëmarrje me ente, ndërmarje apo shoqëri të tjera, duke kryer të gjitha operacionet financiare të nevojshme për arritjen e qëllimit të Shoqërisë.**

---

Tiranë, Njësia Bashkiake nr.5, Rruga "Shkëlqim Fusha" Zona Kadastrale nr.5/3,  
Nr.Pasurisë 2/874, Kati 4;  
Email: [danieli.shpk@gmail.com](mailto:danieli.shpk@gmail.com); Cel: +355 69 388 8668;



**Neni 4**  
**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

**Neni 5**

**Kapitali Themeltar dhe Ortaku i Vetëm**

- 1) Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakut themelues të kësaj Shoqërie, në vlerën 100.000,00 (njëqind mije) Lekë, i përbërë nga 1 (një) pjese me vlerë nominale të një pjese prej 100.000,00 (njëqindmijë) lekësh.
- 2) Ortaku i Vetëm i Shoqërisë është **Z.Daniel Fusha**, atësia Bardhyl, i dtl. 12/12/1995 lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikuar nga karta e identitetit me **Nr. ID J51212043T**.

**Neni 6**  
**Ortaku i Vetëm**

Ortaku i vetëm është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.

**Neni 7**  
**Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

- 1) Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
- 2) Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, **Z.Daniel Fusha**, atësia Bardhyl, i datëlindjes 12/12/1995 lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e identifikuar nga karta e identitetit me **Nr. ID J51212043T**, e cilit zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

**NENI 8**  
**Ekspertët kontabël**

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

---

*Tiranë. Njësia Bashkiake nr.5, Rruga "Shkëlqim Fusha" Zona Kadastrale nr.5/3,  
Nr.Pasurisë 2/874, Kati 4;  
Email: [danieli.shpk@gmail.com](mailto:danieli.shpk@gmail.com); Cel: +355 69 388 8668;*



**NENI 9**  
**Pjesmarrja**

Ortaku themelues mund të vendos me vullnetin e tij, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

**NENI 10**  
**Ngritja e degëve apo filialeve**

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

**NENI 11**  
**Ruajtja e Sekretit**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhduajnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

**NENI 12**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë, të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.

**NENI 13**  
**Dispozitat përfundimtare**

Akt Themelimi u hartua në 3 (tre) kopje, me vlerë të njëjtë juridike për t'u administruar në baze të ligjit, një kopje për t'u dorëzuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe dy kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

**ORTAKU I VETËM**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"DANIELI MILLENNIUM" SHPK**

**Daniel Fusha**

Daniel Fusha  


---

Tiranë, Njësia Bashkiake nr.5, Rruga "Shkëlqim Fusha" Zona Kadastrale nr.5/3,  
Nr.Pasurisë 2/874, Kati 4;  
Email: [danieli.shpk@gmail.com](mailto:danieli.shpk@gmail.com); Cel: +355 69 388 8668;